



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OPËSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPËSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-izlazna

Nr. 1-106

Data 31.07.2018

Sr.

Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në pajtim me nenit 12 pika (d) dhe nenit 40 pika (j) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40 të datës 4 qershor 2008, nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34 i dt.25.04.2016,dhe nenit 39 të Rregullorës të punës së kuvendit , dhe propzimit të Kryetarit të Komunës i dt.17/07/2018 , Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.07.2018, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Memorandum Mirëkuptimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal .
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim :
 - 2.1 Komuna Mitrovicë
 - 2.2 Komuna Skënderaj
 - 2.3 Komuna Drenas
 - 2.4 Komuna Vushtri
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
4. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

T'i dergohet :

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL-së
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesusi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri

Burim Gërguri




02-332/07-0040304/18
17.07.2018


01 m 332-4/395
17.07.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



KOMUNA
MITROVICË



KOMUNA
SKËNDERAJ



KOMUNA
DRENAS



KOMUNA
VUSHTRRI



KOMUNA
OBILIQ

MEMORANDUM MIREKUPITIMI

Palët nënshkruese

1. Komuna e Skenderajt, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
2. Komuna e Mitrovicës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
3. Komuna e Drenasit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
4. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
5. Komuna e Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës

R.LI

Handwritten signature

Neni 1
Qëllimi i Memorandumit

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës, e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të përfshira në këtë Memorandum Mirëkuptimi, të shpallet zonë me interes të përgjithshëm.
2. Zona e Qyqavicës do të shërbejë si urë lidhëse në mes të pesë (5) Komunave të lartcekura, duke përfshirë edhe tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe më gjërë.
3. Me rastin e shpalljes së kësaj zone me interes të përgjithshëm do të krijohet një zonë turistike, rekreative, kulturore dhe biznesore, duke ndikuar në rregullimin e ambientit, kujdesin ndaj ujërave si dhe sipërfaqeve të gjelbëruara.

Neni 2
Obligimet e palëve nënshkruese


1. Palët nënshkruese obligohen të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe të shprehin gatishmërinë për bashkëpunim në realizimin e projekteve të përbashkëta.
2. Palët nënshkruese po ashtu obligohen që të llobojnë dhe të kërkojnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës mjete financiare për ndërtimin e rrugës në gjatësi rreth 18 kilometrave, për t'i lehtësuar investimet në këtë zonë.

Neni 3
Ndërtimet e mundshme në Qyqavicë

1. Në zonën e Qyqavicës, sidomos në majat malore të kësaj pjese, do të ndërtohet fillimisht rruga për të lehtësuar krijimin e zonës turistike, biznesore dhe kulturore, në pjesët në të cilat traseja e rrugës është më e përshtatshme për qarkullim.
2. Në pikat më të larta të bjeshkëve të Qyqavicës do të mund të ndërtohet spitali regional i mushkërive, fusha me terrene sportive, qendra rehabilituese për të moshuarit, krijimi i mini-liqeve artificiale, hotele dhe ndërtime të tjera rekreative, turistike dhe kulturore.

Neni 4
Zgjidhja e kontestave

Palët pajtohen në mes vore që ky Memorandum i Mirëkuptimit, të zgjidhet mes tyre me mirëkuptim. R.L.



Neni 5
Dakordimi në mes të palëve

Të gjitha çështjet e precizuara në këtë marrëveshje do të zbatohen me përkushtimin maksimal të palëve dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Hyryja në fuqi

1. Palët nënshkruesc të këtij memorandumit pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi vetëm nëse kjo Marrëveshje aprovohet nga Kuvendet e Komunave përkatëse konform nenit 40.2 shkronja (j) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale,
2. Ky Memorandum i Mirëkuptimit është nënshkruar në pesë (5) kopje dhe secilës palë nënshkruese i dorëzohet nga një (1) kopje.

Komuna e Mitrovicës Kryetari i Komunës	 Agim BAHTIRI	 Komuna e Skenderakut Kryetari i Komunës Besim JASHARI	 Komuna e Drenasit Kryetari i Komunës Ramiz L. ALIUSI	Komuna e Vushtrisë Kryetari i Komunës	 Xhafer TAHIRI	Komuna e Gbilicqit Kryetari i Komunës	 Xhafer GASHI
---	---	--	---	--	---	--	---